



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI I BASHKIAK

Nr. 836/3 prot.

Pukë, më 28 . 07 . 2025

VENDIM

Nr. 18 datë 25 . 07. 2025

“PËR

DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” I BASHKISË PUKË
Z. Mark Preng Ndoj (pas vdekjes)”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa “m”; ligjit nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr.861 datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.71, datë 27.12.2024 “Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë”, me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, si dhe pas miratimit të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë, Keshilli i Bashkisë Pukë, në mbledhjen e tij me datë 25. 07.2025 ;

VENDOSI:

1. T’i akordojë titullin “QYTETAR NDERI” i Bashkisë Pukë.

Z. MARK PRENG NDOJ(pas vdekjes)

Me motivacionin:

“Për rolin dhe kontributin e tij të çmuar atdhetar e patriotik, duke vënë në shërbim të kombit gjithçka që zotëronte, përfshirë edhe shtëpinë e tij të kthyer në shkollë në Kaftallë, për përhapjen e dijes dhe të gjuhës shqipe.”

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë!
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: Këshilli i Bashkisë, Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e menaxhimit të burimeve njerëzore.
4. Vendimi u shpall me datë 28 .07. 2025.
Vota të vlefshme gjithsej 8
Vota pro 8 , vota kunder 0 , vota abstenim 0

SEKRETARI
Hazbi Terbuni

KRYETARI
Gjon GJOKA

